

UDHËZIM
Nr. 8, datë 2.5.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN E MINISTRIT TË INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË NR. 3, DATË 20.6.2019, “PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS SË
LEHTËSUAR TË AUTORIZIMIT PËR LIDHJEN NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES
TË PROJEKTEVE TË VOGLA TË RINOVUESHME PËR VETËPRODHUESIT E
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA DIELLI”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të pikës 10, të nenit 30, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme të energjisë”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 3, datë 20.6.2019, “Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga dielli”, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Një klient privat, publik apo një klient familjar mund të instalojë një kapacitet total deri në 500 kwp për vetëprodhimin e energjisë elektrike nga dielli ose era, për të mbuluar një pjesë apo të gjithë energjinë që nevojitet për nevojat e tij dhe të injektojë energjinë e tepërt të prodhuar në rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me parashikimet e nenit 30, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme të energjisë”.”.

2. Pika 2, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Injektimi në rrjet do të lejohet për kategorinë e konsumatorëve të përcaktuar, sipas pikës 1 të këtij udhëzimi, të cilët mund të prodhojnë një pjesë ose të gjithë energjinë elektrike që konsumojnë nga impianti fotovoltaiik ose eolik. Bilanci neto dhe faturimi të bëhen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. në baza vjetore për secilën pikë matjeje të autorizuar të klientit. Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. të marrë masa që të reflektojë në faturën mujore gjendjen kumulative kreditore ose debitore të klientit.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE MINISTËR I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku